



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranimi - Primbjenia Nr. Datë: 02-03-2026			
Nr. i Komunitetit	Nomenklatura	Vitet	Shifra Vitetore
01-110/05-280			



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 17 dhe neni 40, shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.02.2026 miraton këtë:

## V E N D I M

**për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues për flet dylli dhe koshere blete, projekt i realizuar ne vitin 2025 dhe 20% e participimit të fermerëve përfitues në mekanizëm bujqësor dhe serra nga subvencionet per vitin 2026, nga kodi 92500 dhe kodi 92503**

### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues për flet dylli dhe koshere blete, projekt i realizuar në vitin 2025 dhe 20% e participimit të fermerëve përfitues në mekanizëm bujqësor dhe serra nga subvencionet për vitin 2026, nga kodi 92500 dhe kodi 92503.

### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është tabela me emrim të projekteve, kodet për subvencione, çmimi i kontraktuar, totali, përqindja e participimit-komunë, shuma e participimit komuna, përqindja e participimit të përfituesve, totali i participimit dhe participimi nga fermerët.

Nr	Emertim I projektit	Kodi për Subvencionim	Sasia e pajisjeve	Çmimi i kontraktuar	Totali	80% participimi komunë	Shuma e participimit - komuna	20% participimi përfituesi	Totali i participimit të fermerëve dhe komunës
1	Koshere 3 katëshe për bletë	92504	120	40	4800	3840	3840	960	4800
2	Flet dylli për bletë	92504	1200 kg	6.7	8040	6432	6432	1608	8040

### Neni 3

Kuvendi i Komunës miraton 20% të participimit të fermerëve përfitues në mekanizëm bujqësor dhe serra nga subvencionet për vitin 2026, nga kodi 92500 dhe kodi 92503.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, dhe DBPZHR-ja.

### Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I  
Bekim Azizi

